Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raporti i Auditimit të Performancës

Projektet e financuara nga grantet e DEMOS

(për vitin 2018)

Prishtinë, dhjetor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare. Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000[1]) si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë[2], efikasitetit[3] dhe efektivitetit[4] dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e këtij raporti "Projektet e financuara nga grantet e DEMOS (për vitin 2018)", në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Vlora Spanca, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që e ka realizuar këtë raport:

Fatlinda Ramosaj, Udhëheqës i departamentit

Donjetë Dreshaj, Udhëheqës i ekipit

Vjosë Bojku, anëtar i ekipit

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT – Adresa: Rr. Ahmet Krasniqi, Nr. 210; Lagjja Arbëria, Prishtinë 10000, Kosovë Tel.: +383(0) 38 60 60 04/1002/1012-FAX: +383(0) 38 2535 122 /219
http://zka-rks.org

[1] SNISA 3000 Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike

[2] Ekonomia –Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së resurseve. Resurset e përdorura duhet të jenë në dispozicion me kohë, në sasi dhe cilësi të duhur dhe me çmimin më të mirë

[3] Efikasiteti – Parimi i efikasitetit nënkupton të marrësh maksimumin nga resurset në dispozicion. ka të bëjë me lidhshmërinë ndërmjet resurseve të angazhuara dhe rezultateve të dhëna në kuptim të sasisë, cilësisë dhe kohës

[4] Efektiviteti – Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritura.

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje e përgjithshme 1
1 Hyrje 1
Objektiva dhe pyetjet e auditimit 2
2 Përshkrimi i fushës së auditimit 3
3 Gjetjet e auditimit 5
3.1 Zhvillimi i procedurave të prokurimit publik mund të përmirësohet tutje 5
3.2 Shumica e projekteve janë realizuar dhe funksionalizuar me kohë 10
4 Konkluzionet 15
5 Rekomandimet 16
Shtojca 1 Informatat rreth komunave përfituese 17
Shtojca 2 Motivi i auditimit, kriteret e auditimit, metodologjia dhe fushëveprimi 18
Motivi i auditimit 18
Objektiva e auditimit 18
Pyetjet e auditimit 18
Kriteret e auditimit 19
Fushëveprimi i auditimit 20
Metodologjia e auditimit 20
Shtojca 3 Përmbledhje e temave të grantit të performancës 21
Shtojca 4 Letërkonfirmimet 22

Lista e shkurtesave

DEMOS	Decentralizimi dhe Përkrahja e Komunave
LPP	Ligji i Prokurimit Publik
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
OE	Operator Ekonomik
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i auditimit "Projektet e financuara nga grantet e DEMOS" është realizuar në bazë të marrëveshjes në mes Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, (përmes Decentralizimit dhe Përkrahjes Komunale). Qëllimi i këtij auditimi është që të vlerësojë nëse procedurat e prokurimit në projektet e audituara ishin kryer në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe nëse investimet janë realizuar dhe funksionalizuar me kohë për përdorim nga qytetarët.

Granti i ndarë u transferohet komunave në kodin e organizatës së tyre dhe mjetet menaxhohen tërësisht nga komuna. Periudha e vlerësuar është viti 2018, i cili po ashtu është viti i parë që komunat shpërblehen për performancë të mirë me këtë marrëveshje e cila do të vazhdojë deri në vitin 2022. Nga gjithsej 38 komuna, përfituese të këtij granti janë 22. Vlera e ndarë për këto 22 komuna për vitin 2018 është 2.25 milion euro. Ne kemi audituar shtatë kontrata në pesë komuna (Prizren, Pejë, Podujevë, Mamushë dhe Graçanicë). Shuma e audituar është mbi 600 mijë euro apo 27% e shumës së ndarë të grantit.

Konkluzioni i përgjithshëm

Auditimi ka konkluduar se projektet ishin funksionalizuar dhe ishin vënë në shërbim të qytetarëve dhe se këta të fundit ishin të kënaqur me investimet. Kërkesat e tyre ishin trajtuar dhe kryesisht ishin marrë për bazë gjatë vendimmarrjes se në cilat projekte do të investohet dhe përfitues nga këto projekte mund të jenë një numër i madh i qytetarëve. Po ashtu, të gjitha komunat kishin aplikuar procedurat e prokurimit në fuqi dhe kishin përdorë procedurën e hapur e cila ofron transparencë dhe mundësi pjesëmarrjeje për të gjithë operatorët ekonomik. Të gjitha komunat e audituara kishin përfshirë projektet në planin e prokurimit, procesi i emërimit të menaxherëve ishte zhvilluar sipas kërkesave ligjore në fuqi dhe fondet e ndara ishin shpenzuar vetëm për projektet kapitale dhe vetëm për qëllimin e kontraktuar. Mirëpo, procesi i prokurimit kërkon vëmendje në disa faza për të gjitha komunat e audituara. Andaj, përkundër realizimit të projekteve për qëllimet e përcaktuara, auditimi ka konkluduar se ka disa të meta që do të duhej të përmirësoheshin në mënyrë që procesi të perfeksionohej.

Kishte raste kur për shkak të mos doganimit me kohë të pajisjes mjekësore kishte vonesë për katër muaj për ta vënë në përdorim pajisjen. Kjo shkaktoi që qytetarët të kërkojnë shërbimin në komunat tjera për këtë periudhë. Po ashtu, procesi i menaxhimit të kontratës do të duhet të monitorohet dhe forcohet më tepër për të arritur rezultatet e synuara. Menaxherët e kontratës nuk monitorohen dhe nuk raportojnë për ndryshimet e mundshme në projekte gjatë implementimit prandaj është e pamundur të dihet çka saktë është shtuar dhe hequr nga paramasa dhe parallogaria. Menaxherët e kontratave nuk ishin të vëmendshëm në mbikëqyrjen e projekteve gjatë punimeve apo edhe në periudhën e garancisë, ku një nga shtatë kontratat e audituara kishte punë të pa përfunduara dhe dy kishin dëmtime gjatë periudhës

së garancisë. Mirëpo, ky auditim kishte ndikim qysh me vizitën tonë në terren, ku me rekomandim të ekipit të auditimit, menaxheri i kontratës (për njërin rast) ka kërkuar nga operatori ekonomik që të përfundoj punët gjatë periudhës së garancisë pa shkaktuar kosto shtesë.

Rekomandim i përgjithshëm

Komunat duhet të vazhdojnë të përfshijnë qytetarët në vendimmarrje dhe prioritizim se në cilat projekte të investohet. Meqë projektet janë për përmirësimin e shërbimeve publike të qytetarëve dhe janë ata që përfitojnë nga to, të shtohet tutje përpjekja për të përfshirë grupe edhe më të mëdha të qytetarëve në këto procese dhe rezultatet nga këto takime të dokumentohen. Përveç kësaj për përmirësim të mëtejmë kanë nevojë edhe disa faza të procesit të prokurimit, me theks të veçantë:

- Të kushtohet vëmendje në aplikimin e procedurave të prokurimit me fokus në përdorimin e drejtë të fjalorit të përbashkët të prokurimit gjatë vlerësimit të ofertave; dhe

- Të forcohet tutje procesi i menaxhimit të kontratave, duke dëshmuar të gjitha ndryshimet në pozicione që ndodhin gjatë implementimit të kontratave dhe të monitorohet plani i menaxhimit duke siguruar që pajisjet pranohen sipas kohës që janë kontraktuar dhe në rast të vonesave të zbatohen penalltitë.

Përgjigjja e palëve të përfshira në auditim

Komunat e përfshira në auditim janë pajtuar me gjetjet dhe rekomandimet e auditimit. Inkurajojmë komunat e përfshira në këtë auditim që ti bëjnë të gjitha përpjekjet për t'i adresuar rekomandimet e dhëna.

(Për konkluzione dhe rekomandime më të detajuara referoju raportit në brendësi)

1 Hyrje

Në vitin 2017, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) ishin pajtuar për krijimin dhe financimin e një sistemi të grantit të performancës për komunat. Granti i performancës ka në dispozicion një buxhet vjetor prej rreth 2.25 milionë euro, për vitet 2018-2021. Të gjitha (38) komunat e Kosovës gëzojnë të drejtën e aplikimit për grantin e performancës. Kushtet minimale që duhet të përmbushin komunat për t'u kualifikuar për marrjen e grantit janë:

- Komuna duhet të nënshkruaj marrëveshje tripalëshe të pjesëmarrjes (komuna, MAPL dhe HELVETAS Swiss Intercooperation);
- Opinioni i auditimit duhet të jetë i pamodifikuar apo i pamodifikuar me theksim të çështjes;
- Komuna duhet të ketë shpenzuar 75% ose më tepër të buxhetit për investime kapitale.

Për vitin 2018 kanë fituar të drejtën e përfitimit të grantit 22 nga 38 komuna.

Ky projekt realizohet nga Decentralizimi dhe Përkrahja e Komunave (DEMOS) dhe Qeveria e Kosovës. DEMOS përkrah komunat në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët nëpërmjet linjave të mëposhtme:

- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve në fushën e hapësirave publike, trafikut komunal dhe menaxhimit të mbeturinave;
- Përmirësimi i menaxhimit financiar dhe transparencës;
- Përmirësimi i demokratizimit të pushtetit lokal dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje;
- Kontributi drejt një kornize të përmirësuar dhe më të harmonizuar të politikave për qeverisjen lokale.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij Granti është nxitja e komunave për të përmirësuar proceset e qeverisjes, të cilat së bashku me kornizën e politikave të përmirësuara do të çojnë në ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët. Duke zhvilluar konkurrencën në mes të komunave, grantet e performancës kanë për qëllim të nxisin ndryshime pozitive në sjelljen e komunave për përmirësimin e qeverisjes demokratike, menaxhimit financiar dhe të burimeve njerëzore, si dhe transparencën dhe integritetin.
Granti i performancës është ndarë për herë të parë për komunat me performancë më të mirë në vitin 2018. Nga këto grante ishin bërë investime në projekte kapitale që komunat përfituese i kishin vlerësuar të rëndësishme.

Shuma e ndarë për vitin 2018 ishte 2,25 milion euro. Shumë e njëjtë pritet të ndahet edhe në tri vitet vijuese (2019-2021).

Objektiva dhe pyetjet e auditimit

Objektivë e këtij auditimi është që të vlerësojmë nëse procesi i prokurimit për projektet kapitale të financuara nga grantet e DEMOS është në pajtim me kërkesat ligjore që nga planifikimi deri te realizimi i kontratës.

Objektivë tjetër e këtij auditimi është që të vlerësojmë edhe nëse këto projekte kanë arritur qëllimin e synuar, d.m.th nëse me anë të këtyre investimeve komuna ka përmirësuar ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët.

Pyetjet kryesore të auditimit janë:

I. A janë kryer procedurat e prokurimit në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik?

II. A ka ndikuar projekti i financuar në përmirësimin e shërbimeve publike për qytetarët?

Ky auditim ka mbuluar shtatë kontrata (nga granti i ndarë për vitin 2018): tri në Komunën e Pejës, një në Komunën e Prizrenit (dy projekte të realizuara në një kontratë), një në Komunën e Podujevës, një në Komunën e Mamushës dhe një në Komunën e Graçanicës. Përzgjedhjen e komunave dhe projekteve për auditim e kemi bërë bazuar në shpenzimet më të larta edhe ato më të ulëta, në mënyrë që të kemi një pasqyrë të qartë për komunat e madhësive të ndryshme. Po ashtu, në përzgjedhje të komunave është marr parasysh edhe kriteri i popullatës së margjinalizuar[5]. Është audituar procesi që nga kërkesat e qytetarëve, prioritizimi i këtyre kërkesave, aprovimi i projekteve, përfshirja e projekteve në planet e prokurimit, procedurat e tenderimit, dhënia e kontratave dhe deri tek pranimi i projekteve.

Për informatat rreth komunave përfituese, projekteve në të cilat është investuar dhe metodologjisë së auditimit referohuni tek *shtojca 1 dhe 2*.

[5] Grupe të ndryshme njerëzish brenda një kulture, konteksti dhe historie të caktuar në rrezik që të nënshtrohen diskriminimit të shumëfishtë për shkak të bashkëveprimit të karakteristikave ose bazave të ndryshme personale, siç janë seksi, gjinia, mosha, përkatësia etnike, feja ose besimi, statusi shëndetësor, paaftësia, etj. orientimi seksual, identiteti gjinor, arsimi ose të ardhurat, ose të jetuarit në lokalitete të ndryshme gjeografike. (https://eige.europa.eu/thesaurus/terms/1280) (http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2018/03/Kushtetuta.e.Republikes.se_.Kosoves-2.pdf)

2 Përshkrimi i fushës së auditimit

Granti i performancës nënkupton procesin ku komunat përfitojnë mjete financiare në bazë të performancës së tyre në fushat e përzgjedhura. Kushtet minimale që komunat duhet të plotësojnë për të qenë të përshtatshme që të marrin pjesë në grantin e performancës janë: administrimi i shëndoshë financiar dhe shkalla e mirë e shpenzimeve në investime kapitale. Pasi komunat të plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe të kualifikohen, vlera e grantit përcaktohet nga pikët (rezultati) relative të komunave në një sërë treguesish të performancës. Granti i performancës bashkë-financohet nga Qeveria e Kosovës (jashtë alokimit buxhetor të MAPL) dhe SDC.

Grantet e performancës u ndahen komunave në pajtim me pikët e arritura në performancën komunale në bazë të një numri treguesish të fokusuar në tri fusha kryesore: qeverisje demokratike, menaxhim komunal dhe integritet dhe transparencë.

Për të gjitha komunat që i kanë plotësuar kushtet minimale, granti që merr secila komunë bazohet në pikët relative të saj kundrejt 27 treguesve të performancës[6]. Granti i performancës vihet në dispozicion të komunave si shtesë vjetore mbi grantin e përgjithshëm, madhësia e të cilit përcaktohet në bazë të formulës për alokimin e grantit me variabla, si: madhësia e popullsisë, sipërfaqja dhe përbërja etnike, që llogariten mbi shumën fikse bazë[7].

Për shpenzimin e grantit të performancës, zbatohen të gjitha rregullat ekzistuese të qeverisë (të cilat zbatohen për investimet kapitale në kuadër të grantit të përgjithshëm) në aspektin e përdorimit të grantit, planifikimit të grantit, si dhe të raportimit dhe llogaridhënies. Komunat përdorin procedurat vendore të tenderimit, kontraktimit dhe pranimit teknik. Komunat duhet të përdorin grantin për investime kapitale sipas prioriteteve dhe nevojave të tyre, në përputhje me legjislacionin e Kosovës.

[6] Përmbledhje e temave të grantit të performancës (shtojca 3)
[7] Formula e alokimit për grantin e përgjithshëm është përkufizuar në Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal (Ligji nr. 03/ L- 049)

Grafiku 1: Procesi i prokurimit publik



Diagrami paraqet pikat kryesore të procesit të prokurimit publik në Kosovë, ku të gjitha fazat janë aplikuar në komunat e audituara. Komunat e përzgjedhura për auditim kanë përdorur procedurën e hapur në kontraktimin e projekteve. Procedura e hapur karakterizohet nga fakti se kushdo, pavarësisht kualifikimit dhe kapacitetit, mund të tenderoj për kontratë. Kjo është një procedurë që ofron transparencë dhe konkurrencë të barabartë për të gjithë tenderuesit.

3 Gjetjet e auditimit

Ky kapitull pasqyron gjetjet që janë evidentuar gjatë procesit të auditimit të projekteve kapitale të financuara nga DEMOS. Gjetjet janë përmbledhur në formën e pyetjeve kryesore të auditimit në mënyrë që të përshkruhet sa më qartë i gjithë procesi duke përfshirë aplikimin e procedurave të prokurimit në projektet e audituara dhe përfshirjen e kërkesave të qytetarëve (duke përfshirë edhe grupet e margjinalizuara) në investimet e bëra.

3.1 Zhvillimi i procedurave të prokurimit publik mund të përmirësohet tutje

Të gjitha komunat përfituese të grantit të performancës janë të obliguara që për projektet të cilat financohen nga ky grant, të aplikojnë ligjet dhe rregulloret e Republikës së Kosovës. Të gjitha komunat e audituara kishin përdorur ligjin dhe rregulloret në fuqi që rregullojnë procedurat e prokurimit publik dhe kishin aplikuar procedurën e hapur të tenderimit, që është njëra prej procedurave që ofron transparencë më të madhe dhe mundësi aplikimi për të gjithë operatorët e ekonomik (OE). Mirëpo, në të gjitha komunat e audituara kërkohet shtimi i vëmendjes në disa pika të procesit të prokurimit. Për shkak të përshpejtimit të procedurave për përfundimin e projekteve, komunat nuk kishin performuar plotësisht me kërkesat e prokurimit publik. Mos aplikimi në mënyrë të duhur i procedurave të prokurimit kishte rezultuar me shpërblimin e OE më të shtrenjtë, tejkalimin e vlerës së parashikuar të kontratës, vonesë në shpërndarje të mallit edhe vonesë në nënshkrimin e kontratave.

Projektet ishin planifikuar në mënyrë të duhur

Për të ofruar një pasqyrë transparente se në çka pritet të investohet nga komuna, të gjitha projektet që planifikohet të investohet gjatë vitit duhet të jenë të përfshira në planin vjetor të prokurimit publik. Të gjitha komunat e audituara (Prizreni, Peja, Podujeva, Mamusha dhe Graçanica) kishin përfshirë projektet në planin e prokurimit dhe kishin zhvilluar procedurat e prokurimit sipas ligjit dhe rregulloreve në fuqi për ato projekte. Vetëm Komuna e Mamushës nuk e kishte paraparë projektin në planin vjetor të prokurimit, mirëpo komuna kishte njoftuar me kohë Agjencinë Qendrore të Prokurimit për zhvillimin e procedurës së prokurimit duke e siguruar edhe disponueshmërinë e mjeteve. Të gjitha projektet e audituara po ashtu figurojnë në raportin e kontratave të nënshkruara.

Procedurat e prokurimit publik kërkojnë përmirësim të mëtejmë

Nga pesë komunat e audituara, katër[8] prej tyre kishin mangësi në aplikimin e procedurave të prokurimit, ndërsa Komuna e Graçanicës nuk kishte mangësi në zhvillimin e procedurave sipas rregullave të LPP.

Në mënyrë që të sigurohen parakushtet për përfundimin e plotë të projektit, Autoritetet Kontraktuese (AK) duhet para inicimit të çdo aktiviteti të prokurimit të bëjnë një vlerësim të mirë të nevojave duke e parashikuar vlerën e përafërt të kontratës dhe alokimin e mjeteve. Komuna e Podujevës në projektin "Lumi Llap – vazhdim" kishte tejkaluar vlerën e parashikuar të kontratës për 9,751 euro, çka do të thotë se komuna nuk kishte planifikuar mirë dhe një planifikim jo i mirë rrezikon që projekti mos të ketë mjetet të mjaftueshme për t'u përfunduar.

Për më shumë, Komuna e Podujevës në këtë projekt, kishte shpërblyer OE me çmim më të lartë për 23,085 euro apo 17% se oferta tjetër më e lirë. OE me çmim më të ulët ishte skualifikuar me arsyetimin se nuk plotësonte një nga kriteret e përzgjedhjes "që në tre vitet e fundit të ketë punë të ngjashme në vlerë prej 225 mijë euro". Komisioni i vlerësimit kishte vlerësuar se dëshmitë e ofruar nga OE i papërgjegjshëm nuk ishin për punë specifike siç është shtrimi i një lumi, megjithatë, shifra (45000000-7) e përdorur në këtë procedurë nga Fjalori i Përbashkët i Prokurimit[9] përfshinë punë ndërtimore, e që OE i skualifikuar kishte dëshmi se kishte kryer punë të ngjashme me ato të kontraktuara nga Komuna e Podujevës (punë që mund të kualifikohen si të ngjashme). Për më tepër, të dy OE (fituesi dhe OE më çmim më të ulët i skualifikuar), si aktivitet primarë të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, kishin ndërtimin e objekteve banesore dhe jo banesore, çka do të thotë se të dy operatorët do të mund të llogariteshin të kualifikuar për të kryer punët e ngjashme. Nëse do të shpërblehej me kontratë OE me çmim më të lirë, buxheti do të kursehej.

Në procesin e zhvillimit të procedurave, mangësi kishte edhe projekti i Komunës së Prizrenit "Ndërtimi i miniparqeve, furnizimi dhe vendosja në hapësira publike të ulëseve, koshave për plehra dhe ndriçimit publik në Komunën e Prizrenit", kontrata e së cilit u nënshkrua me pesë muaj vonesë. Kjo kishte ndodhur për shkak të ankesave nga OE jo fitues në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Si pasojë punët kishin filluar me vonesë, tek në vitin 2019. Megjithatë, komuna kishte ndjekur hapat e duhur për të marr aprovimin nga donatori për transferim të mjeteve në vitin fiskal 2019 dhe projekti ka vazhduar të implementohet.

Kontrata e nënshkruar në mes Komunës së Prizrenit dhe OE në dosje të tenderit kishte specifikuar që artikujt e ofruar nga ana e OE të jenë të nënvizuar në katalog në mënyrë që të dihet saktë cilët artikuj po ofertohen. Mirëpo, komisioni i vlerësimit nuk ishte në gjendje të na ofrojë dëshmi për vlerësimin e kësaj kërkese, pra nuk kishte të nënvizuar se cilat produkte të

[8] Komunat: Podujevë, Mamushë, Prizren dhe Pejë.

[9] Shifrat se çfarë përfshinë furnizimi, shërbimi dhe puna

katalogut ishin ofertuar. Mungesa e dëshmive se si është bërë vlerësimi i specifikacioneve (produkteve) nga komisioni rrezikon që komuna të pranoj produkte të cilat nuk janë pjesë e dosjes së tenderit. Kjo pastaj mund të rezultojë në mos përmbushjen e projekteve ashtu siç ishin planifikuar.

Në tri projektet e audituara të Komunës së Pejës, një nga kërkesat e dosjes së tenderit ishte plani dinamik dhe deklarata e plotësuar, nënshkruar dhe vulosur nga OE mbi planin dinamik për kryerjen e punëve. Komuna e Pejës edhe pse i kishte kërkuar këto dëshmi nga OE vetëm njeri[10] nga tri projektet e audituara i kishte ato në Dosjen e Tenderit. Kjo kishte ndodhë pasi që në dosjen e bashkëngjitur ishte plani dinamik dhe si i tillë ishte marrë dëshmi e mjaftueshme (pa deklaratën e nënshkruar). Edhe pse kjo nuk është materializuar me ndonjë rrezik, megjithatë kërkesat e vendosura në dosje të tenderit duhet të respektohen.

Kërkohet përmirësim në menaxhimin e kontratave

Në të gjitha kontratat e audituara procesi i emërimit të menaxherëve ishte në rregull dhe sipas kërkesave ligjore. Mirëpo, menaxherët e kontratave duhet t'i kushtojnë vëmendje planit të menaxhimit të kontratës i cili në të gjitha rastet është plotësuar vetëm në aspektin e përgjithshëm të informatave dhe nuk përmban detaje të tjera rreth përmbushjes së kushteve të kontratës.

Në kontratën "Lumi Llap - vazhdim" në komunën e Podujevës, menaxheri i kontratës raportimet i bën në drejtorinë e urbanizmit në formë verbale, ndërsa nuk ka raporte me shkrim mbi zhvillimin e punimeve në terren.

Në kontratën "Furnizim me pajisje për analiza biokimike" në Komunën e Mamushës tek kushtet e veçanta ishte specifikuar që afati i liferimit për furnizim me pajisje mjekësore për analiza biokimike është 30 ditë. Komuna e kishte pranuar pajisjen me katër muaj vonesë. Arsyeja e vonesës së pajisjes sipas zyrtarëve ishte marrja e lejes për zhdoganimin e mallrave. Kjo vonesë i ka shkaktuar Qendrës së Mjekësisë Familjare në Mamushë që për një periudhë të mos u ofrohen këto shërbime qytetarëve, por të udhëzohen në vende tjera. OE nuk është penalizuar në këtë rast nga Autoriteti Kontraktues (AK) fare. Kjo ka ndikuar në mos ofrimin e shërbimeve me kohë për qytetarët dhe në kursimin e mundshëm të buxhetit.

Të gjitha projektet duhet të kenë menaxher të kontratave ose Organ Mbikëqyrës në rastet e kontratave me vlera të mëdha. Komuna e Prizrenit kishte të kontraktuar një Organ Mbikëqyrës për mbikëqyrjen e realizimit të projekteve kapitale. Organi mbikëqyrës kishte raportuar në baza të rregullta në departamentin e shërbimeve publike në të cilin janë të autorizuar dy zyrtarë që ti verifikojnë punët e kryera. Gjithashtu, komuna kishte emëruar edhe menaxherin e kontratës që ishte drejtori i shërbimeve publike, praktikë kjo karakteristike e Komunës së Prizrenit, pasi që drejtori i shërbimeve publike ishte po ashtu MK tek të gjitha

[10] Projekti i ndriçimit publik në fshatin Broliq.

projektet kapitale të cilat ishin duke u realizuar. Praktika e angazhimit të dy mbikëqyrësve në të njëjtat projekte shkakton dyfishim të punës.

Për të gjitha projektet e audituara, po ashtu kemi bërë ekzaminime fizike për të verifikuar nëse projektet ishin realizuar ashtu siç ishin kontraktuar.

Në projektin e Komunës së Podujevës dhe në një[11] projekt të Komunës së Pejës kemi vërejtur që kishte disa dëmtime të vogla pas pranimit teknik të projekteve (foto 1 dhe 2), ndërsa në projektin e tretë puna nuk ishte përfunduar plotësisht sipas kontraktimit (foto 3). Menaxheri i kontratë do të duhet të sigurohej se punët e pa kryera fillimisht janë kryer në përputhje me kontratën, ndërsa në rastet e dëmeve pas pranimi teknik të sanohen brenda periudhës së garancisë, pasi që kontratat përfshinin periudhën e garancionit një vit pas pranimit teknik të projektit. Menaxheri i kontratës që duhej të bënte kërkesë tek OE-të për sanimin e dëmeve nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim të tillë. Pas vizitës sonë në terren dhe rekomandimit të dhënë menaxherit të kontratës (Komuna e Pejës), ka kërkuar që të rregullohen dëmet dhe OE ka bërë rregullimin e kubëzave të dëmtuara (foto 4). Rregullimi i këtyre dëmeve ka pasur efektin e vet në kursimin e mjeteve shtesë të cilat do të duhej të paguante komuna nëse nuk do të bëhej sanimi i dëmit gjatë periudhës së garancionit. Sanimi i dëmeve është bërë vetëm në projektin "Xhemajl Kada", për dy projektet tjera nuk na është ofruar dëshmi që ka ndodhë një gjë e tillë.

Foto 1 dhe 2: Projekti "lumi Llap- vazhdim"- Podujevë ku shihen shtyllat pa kupola dhe projekti "Kubëzimi, gjelbërimi dhe ndriçimi publik në lagjen Puhovc"- Pejë, ku shihen kubëzat e dëmtuara



Foto 3 dhe 4: Projekti "Rregullimi i parkingut, trotuarit, ndriçimit dhe kubëzimit në lagjen Xhemajl Kada" – Pejë, ku shihen kubëzimet që ishin dëmtuar dhe foto tjetër dëmet e rregulluara pas vizitës sonë në terren

[11] "Rregullimi i parkingut, trotuarit, ndriçimit dhe kubëzimit në lagjen Xhemajl Kada" dhe "Kubëzimi, gjelbërimi dhe ndriçimi publik në lagjen Puhovc"

Në po këto dy projekte në Komunën e Pejës kishte ndryshim të pozicioneve dhe këto ndryshime kishin ndodhur në marrëveshje në mes OE dhe menaxherit të kontratës, ndryshime këto të cilat përveç që vërehen në terren nuk figurojnë në situacionin e dërguar për pagesë ku figuron edhe nënshkrimi i menaxherit të kontratës. Ndryshimet ishin në gërmimin e prapa murit mbrojtës si dhe gërmimi i kanalit për vendosjen e gypit të drenazhës; mbushja me zhavorr e hapësirës prapa murit si dhe kanalit të gypit të drenazhës; furnizimi me material, transporti dhe vendosja e gypit të drenazhës ("Xhemajl Kada"), pozicione të cilat ishin shtuar duke hequr sasinë e gurëve skajorë prej betoni (pozicioni 3.6) për 90m më pak; pozicioni 6.8 (shtyllat metalike konike të zinkuara) nuk ishin vendosur fare dhe kubëzat prej betoni (pozicioni 3.8) ishin vendosur 15m^2 më pak.

Ndërsa, në projektin e Puhovcit ishin shtuar shtatë pozicione të reja të cilat nuk ishin në kontratë dhe ishin barazuar me mbetjet e pozicionit 3.5 dhe 3.6 (furnizimi me material dhe vendosja e gurëve skajor dhe furnizimi, transporti dhe vendosja e kubëzave të granitit natyror).

Nuk kishte ndonjë dëshmi tjetër se si ka ndodh procesi i ndryshimit dhe barazimit të pozicioneve. Ndryshimet e pa dokumentuara rrezikojnë që AK mos t'i marrë punimet e kontraktuara.

Fondet ishin shpenzuar për qëllimet e kontraktuara

Sipas marrëveshjes në mes të MAPL-DEMOS, të gjitha fondet e ndara për grantin e performancës duhet të shpenzohen ekskluzivisht vetëm për projektet kapitale dhe vetëm për qëllimin e kontraktuar. Të gjitha komunat e audituara kishin nënshkruar kontrata për investime kapitale dhe shpenzimet e bëra ishin për të njëjtat projekte që janë kontraktuar.

Po ashtu, pjesë e marrëveshjes është edhe që shpenzimi i mjeteve të bëhet brenda vitit fiskal (konkretisht për këto projekte viti fiskal ishte 2018), mirëpo vetëm Komuna e Prizrenit nuk kishte arrit që të filloj implementimin e projektit brenda vitit 2018 për shkak të vonesave në procedurat e prokurimit. Megjithatë kjo komunë në marrëveshje me DEMOS, kishte bërë bartjen e fondeve për vitin 2019 dhe projekti kishte vazhduar të implementohet gjatë vitit 2019.

3.2 Shumica e projekteve janë realizuar dhe funksionalizuar me kohë

Në procesin e prioritizimit dhe përcaktimit të projekteve në të cilat duhet investuar komuna duhet të përfshijë edhe kërkesat dhe nevojat e qytetarëve. Përderisa, qëllimi i këtyre projekteve është të jenë në shërbim të qytetarëve, komunat duhet të përfshijnë edhe qytetarët në procesin e përcaktimit se në cilin projekt të investohet me fondet e grantit të performancës.

Procesi i përfshirjes së kërkesave të qytetarëve për projektet e audituara nuk ishte i dokumentuar e as prioritizimi i këtyre projekteve. Komunat përveç mbajtjes së dëgjimeve publike, janë të hapura edhe për pranimin e kërkesave individuale nga qytetarët. Megjithatë, nuk kanë politika tjera për të rritur përfshirjen edhe me të madhe të qytetarëve në planin e investimeve. Pavarësisht mungesës së politikave gjithëpërfshirëse, të gjitha projektet e audituara janë realizuar dhe janë në shërbim të qytetarëve. Gjashtë[12] nga shtatë projektet e audituara ishin funksionalizuar me kohë, gjë që ka rezultuar me rritjen e sigurisë, përmirësimin e hapësirave/shërbimeve publike dhe krijimin e mundësive për rekreacion për fëmijët.

Diagrami 1: Procesi i përfshirjes së kërkesave të qytetarëve

[12] Vetëm projekti në komunën e Prizrenit ka vonesa në fillimin e implementimit, I cili ka filluar të implementohet në vitin 2019

Qytetarët ishin konsultuar gjatë marrjes së vendimeve për investim, përderisa kërkesat ishin trajtuar pjesërisht

Praktika e përfshirjes së kërkesave të qytetarëve dhe mënyra e vendosjes se në çfarë do të investohet ndryshon nga komuna në komunë. Praktikë dhe obligim i komunave është që të mbajnë dëgjime publike me qytetarët rreth problemeve të mundshme dhe vështirësive që hasin. Katër[13] nga pesë komunat e audituara kishin procesverbale të dëgjimeve publike që ishin organizuar me qytetarët. Në këto procesverbale ishin trajtuar tema dhe shqetësime të ndryshme të qytetarëve. Po ashtu, komunat kishin aplikuar edhe mënyrën e pranimit të kërkesave nga qytetarët në formë të shkruar dhe direkt në zyrat e komunës.

Fakti që këto janë mënyrat e vetme të përfshirjes së kërkesave të qytetarëve nënkupton që këta të fundit mund të kenë hapësirë të kufizuar për të qenë pjesë e vendimmarrjes se në çfarë të investohet. Po ashtu, komunat e audituara nuk kishin bërë përpjekje tjera për informim më të gjerë të publikut rreth takimeve të mbajtura.

Vlen të theksohet që pothuajse të gjitha projektet e investuara ishin përfshirë, qoftë në dëgjime buxhetore, strategjitë investive apo në planet e integritetit, megjithatë mënyra se si është vendosur që pikërisht këto projekte të jenë prioritet është vetëm përmes diskutimeve brenda drejtorëve të departamenteve.

Procesi i vendim marrjes për investim sipas komunave

Komuna e Podujevës, përzgjedhjen e projektit për të investuar e kishte bërë me takime jo formale të drejtorëve të sektorëve përkatës, me ç 'rast në diskutim e sipër ishte vendosur se ku është më e domosdoshme të investohet. Komuna kishte mbajtur edhe dëgjime publike (por të cilat nuk ishin publikuar në faqen e internetit - ueb faqe), ku ishte trajtuar edhe problemi i lumit Llap. I njëjti projekt ishte edhe në Kornizën Afatmesme Buxhetore (2016-2018) të komunës, i cili është projekt në vazhdimësi dhe pritet të vazhdojë edhe në vitet në vijim.

Komuna e Mamushës nuk kishte mbajtur dëgjime publike për qytetarët për vitin 2018 dhe procesi i vendosjes se në çfarë do të investohet nuk ishte dokumentuar. Mirëpo, në planin e integritetit të komunës për vitin 2016-2020, objektivë është edhe ngritja e cilësisë së ofrimit të shërbimeve shëndetësore për banorët e saj, domen ky në të cilin ishte investuar me grantet e performancës së dhënë nga DEMOS.

Komuna e Graçanicës kishte një plan të investimeve në komunë në të cilin ishin të planifikuara edhe investimet në ndriçim e me fokus ndriçimet me LED, ku ishte përshkruar qartë mënyra e shpërndarjes së ndriçimit nëpër territorin e komunës. Edhe pse nga procesverbalet që gjenden në faqen elektronike (ueb faqe) të komunës, nuk kishte kërkesa nga qytetarët për të

[13] Komunat e Podujevës, Graçanicës, Prizrenit dhe Pejës, ndërsa komuna e Mamushës nuk ka mbajtur dëgjime publike për vitin 2018.

investuar në ndriçim publik, ky projekt ishte në vazhdimësi dhe ishte pjesë e planit të veprimit për vitet 2015-2018.

Ndërsa, Komuna e Prizrenit nuk kishte aprovuar strategjinë e investimeve, pjesë e të cilës do të ishin planet e investimeve për vitin 2018. Andaj procedura e prioritizimit të investimit nuk është e dokumentuar as në Komunën e Prizrenit.

Në anën tjetër Komuna e Pejës ishte komuna që më së shumti kishte mbajtur dëgjime publike me qytetarët. Nga procesverbalet vërehet qartë se të gjitha projektet në të cilat është investuar janë diskutuar dhe trajtuar gjatë këtyre dëgjimeve publike. Ajo çfarë nuk është dokumentuar është mënyra e prioritizimit të projekteve.

Tabela 1: Mbajtja e dëgjimeve publike[14] në komunat e audituara

Komuna	*Numri i dëgjimeve të mbajtura*	*Vendi i mbajtjes së dëgjimeve*		*A është trajtuar projekti në dëgjime publike?*	*A është projekti në shfrytëzim për qytetarët?[15]*
		Qytet	*Fshat*		
Peja	*19*	*10*	*9*	*Po*	*Po*
Graçanica	*7*	*7*	*0*	*Jo*	*Po*
Prizreni	*5*	*5*	*0*	*Po*	*Po[16]*
Podujeva	*4*	*1*	*3*	*Po*	*Po*
Mamusha	*0*	*0*	*0*	*NA*	*Po*

Nga tabela 1 shohim që më së shumti dëgjime publike kishte mbajtur Peja, pastaj Graçanica për të përfunduar me Mamushën e cila nuk kishte mbajtur dëgjime publike për vitin 2018. Ndërsa, në anën tjetër shohim po ashtu që Komuna e Pejës e ka shtri mbajtjen e dëgjimeve publike edhe në fshatra duke balancuar me numrin e dëgjimeve publike të mbajtura në qytet. Kjo kishte rezultuar me gjithë-përfshirje të qytetarëve në informim dhe shprehje të

[14] Sipas procesverbaleve të dëgjimeve publike të vitit 2017
[15] Për vitin 2018
[16] Funksionalizimi i projektit është bërë në vitin 2019

shqetësimeve. Në këtë mënyrë i'u është dhënë mundësia e barabartë të gjithë qytetarëve që të shprehin kërkesat e tyre dhe të njëjtat të mund të merren parasysh për investime.

Përfshirja e grupeve të margjinalizuara të shoqërisë mund të fuqizohet tutje

Asnjëra nga komunat e audituara nuk kishte ndonjë procedurë të veçantë për përfshirjen e kërkesave të grupeve të margjinalizuara në procesin e vendimmarrjes për investim. Procesi i njëjtë me dëgjime publike aplikohet për të gjithë qytetarët dhe pjesëmarrja është e hapur për të gjithë.

Në shumicën e komunave të audituara mënyra e informimit të qytetarëve ishte duke e vendosur shpalljen në hyrjen e objektit të komunës dhe në faqen zyrtare të internetit (ueb faqe) të komunës. Ka komuna të cilat bëjnë lajmërimin për mbajtjen e dëgjimeve publike edhe përmes rrjeteve sociale siç është Facebook[17].

Vlen të ceket që të gjitha projektet e investuara ishin të hapura dhe të qasshme për të gjithë qytetarët, përfshirë grupet e margjinalizuara. Për më tepër, ishin edhe në lagje që përfshijnë grupe të ndryshme të qytetarëve.

Megjithatë, komunat do të mund të zhvillonin mënyra apo mekanizma tjerë që informimi i qytetarëve për mbajtjen e dëgjimeve publike të jetë edhe më i gjerë.

Projektet janë funksionalizuar dhe janë në përdorim të qytetarëve

Kusht i përcaktuar i marrëveshjes ishte që projektet të funksionalizohen për përdorim brenda vitit 2018. Të gjitha projektet e audituara ishin funksionalizuar me kohë, përveç projektit në Komunën e Prizrenit, i cili është funksionalizuar në vitin 2019[18]. Megjithatë, Komuna e Prizrenit e kishte marrë aprovimin nga donatori për këtë shtyrje të afatit.

[17] Komuna e Pejës dhe Prizrenit
[18] Ekzaminim fizik në terren

Foto 5: Projektet e audituara

Gjatë ekzaminimit në terren të këtyre projekteve ne kemi intervistuar edhe disa qytetarë të rastit për të marrë informata nga ata të cilëve u dedikohen këto projekte se çfarë mendimi kishin për to. Qytetarët gjatë këtyre bisedave, i kanë cilësuar këto projekte si të domosdoshme dhe mirë të punuara. Për më tepër, edhe në rastet kur ka pasur ndonjë prishje në këto projekte, qytetarët na thanë se kishin lajmëruar komunën dhe ishte bërë intervenimi me kohë për të rregulluar dëmet.

4 Konkluzionet

Përfshirja e kërkesave të qytetarëve në vendimmarrje nga shumica e komunave të audituara, tregon që qëllimi i ndarjes së grantit të performancës është arritur. Përfshirja e këtyre kërkesave ka rezultuar që projektet në të cilat është investuar të jenë në shërbim të shumicës së qytetarëve të komunave gjegjëse. Megjithatë, prioritizimi i këtyre projekteve krahasuar me projektet tjera duhet të dokumentohet.
Të gjitha projektet e audituara në të cilat është investuar nga granti i performancës kanë arritur të funksionalizohen dhe të lëshohen për përdorim për qytetarët brenda kohës së dakorduar me donatorin. Pavarësisht funksionalizimit të projekteve për qytetarët, zhvillimi i procedurave të prokurimit në përputhje me kërkesat ligjore kërkon rritje të vëmendjes në mënyrë që ky proces të përsoset tutje.
Dobësitë e identifikuara në hallka të ndryshme të zhvillimit të procedurave të prokurimit (secila komunë në ndonjë pjesë të procesit), tregojnë që komunat e audituara kanë nevojë t'i kushtojnë vëmendje më të madhe disa proceseve, duke filluar nga futja e projekteve në planin e prokurimit, zhvillimin e procedurave e deri tek menaxhimi i kontratës. Si pasojë e mos referimit në mënyrë të duhur në Fjalorin e Përbashkët të Prokurimit, Komuna e Podujevës kishte shpërblyer operatorin ekonomik më çmim më të shtrenjtë për 17% se operatori ekonomik i papërgjegjshëm. Një njohje më e mirë e përdorimit të këtij fjalori, do të mund të rezultonte me shtrimin e disa metrave më shumë të shtratit të lumit.

Mos kujdesi i mjaftueshëm i menaxherit të kontratës që të monitoroj operatorin ekonomik ka ndikuar që në Komunën e Mamushës pajisja për analiza biokimike të arrijë me katër muaj vonesë. Kjo ka shkaktuar që qytetarët të mos mund të shfrytëzojnë pajisjen me kohë dhe për të njëjtën të kërkohen shërbimet në qytetet tjera. Mangësi në menaxhimin e kontratës kishte edhe Komuna e Pejës, kur menaxherët e kontratave nuk kishin dokumentuar mjaftueshëm ndryshimet në pozicione që i kanë aprovuar gjatë zbatimit të kontratave.

Dy nga projektet e audituara kishin dëmtime pas përfundimit të punëve dhe një projekt nuk ishte përfunduar plotësisht (foto 3). E mira e kësaj ishte se komunat kishin mjetet për të sanuar këto dëme siç është garancia një vjeçare pas përfundimit të punëve. Pas punës në terren të ekipit të auditimit, me rekomandimin tonë, menaxheri i projektit ka kërkuar të bëhen këto sanime dhe në njërin projekt veçse janë bërë ndërhyrjet. Shfrytëzimi i këtyre garancive edhe për rastet tjera ndikon që të sanohen dëmet pa shpenzuar buxhet shtesë komuna.
Komunat e audituara nuk kanë arritur të dokumentojnë mënyrën e prioritizimit të investimeve në projektet përkatëse. Ani pse kryesisht ishin mbajtur dëgjime publike me qytetarët dhe projektet e investuara ishin qoftë në strategjitë për investime apo në planin e punës, komunat nuk kanë proces standard të pranimit të kërkesave, shqyrtimit të tyre dhe prioritizimit të tyre për investim. Sidoqoftë, të gjitha projektet ishin përfunduar dhe ishin të qasshme për të gjithë qytetarët pa dallim. Pas intervistimit të disa qytetarëve të rastit, këta të fundit vlerësojnë se investimi ishte i duhur dhe frytdhënës.

5 Rekomandimet

Në mënyrë që investimet nga granti i performancës të arrijnë qëllimet e plota të tyre dhe në mënyrë që procesi i përfshirjes së kërkesave të qytetarëve dhe procesi i prokurimit të avancohet, Zyra Kombëtare e Auditimit rekomandon që:

- Të dokumentohet se si është bërë prioritizimi i projekteve në të cilat do të investohet. Edhe pse kërkesat e qytetarëve janë marrë parasysh dhe janë trajtuar qoftë gjatë dëgjimeve publike apo takimeve mes drejtorëve të departamenteve, këto diskutime nuk janë dokumentuar mjaftueshëm. Dokumentimi i tyre do të arsyetonte se pse është investuar në projekte të caktuara;

- Të forcohen tutje kontrollet e brendshme në hallkat ku janë identifikuar dobësitë në komunat gjegjëse dhe të parandalohet rreziku që të përsëritën dobësitë e njëjta apo dobësi tjera të mundshme;

- Fjalori i Përbashkët i Prokurimit të përdoret në mënyrë të duhur duke siguruar që të shpërblehet me kontratë oferta me çmimin më të ulët. Të ketë parasysh që punët e ngjashme janë dëshmi se operatori mund të kryej punët që hyjnë në të njëjtën shifër të këtij fjalori;

- Menaxherët e caktuar të projekteve të përcjellin me përpikëri procesin e menaxhimit dhe sigurohen se mallrat apo shërbimet janë në dispozicion për përdorim në përputhje me kohën e kontraktuar. Në rast të vonesave të aplikohen masat ligjore siç janë penalltitë. Ndërsa, Komuna e Pejës të sigurohet se çdo ndryshim i pozicioneve të kontratës që ndodhë të dokumentohet; dhe

- Të sigurohen se garancia për sanimin e dëmeve është shfrytëzuar për të gjitha rastet, ashtu siç është paraparë me kontratë në mënyrë që të sanohen dëmet pa kosto shtesë për komunën.

Shtojca 1 Informatat rreth komunave përfituese

HELVETAS KOSOVO		Shuma e alokuar e grantit për komunë për vitin 2018					
#	Komuna	DEMOS/MAPL	Komuna	Totali	Shpenzimi	Pjesa e mbetur	Nr i projekteve për 2018
1	Gjilan/Gnjilane	205,008.00 €	189,288.60 €	394,296.60 €	205,000.00 €	8.00 €	1
2	Gračanica/Graçanicë	9,521.00 €	12,841.60 €	22,362.60 €	18,986.50 €	0.00 €	1
3	Hani i Elezit/Elez Han	29,970.00 €	100,000.00 €	129,970.00 €	29,970.00 €	0.00 €	1
4	Istog/Istok	119,454.00 €	30,546.00 €	150,000.00 €	146,687.50 €	0.00 €	5
5	Junik/Junik	25,628.00 €	14,992.00 €	40,620.00 €	33,792.50 €	0.00 €	2
6	Kaçanik/Kačanik	84,138.00 €	25,351.40 €	109,489.40 €	88,466.71 €	0.00 €	2
7	Klinë/Klina	75,614.00 €	45,386.00 €	121,000.00 €	117,247.25 €	0.00 €	4
8	Lipjan/Lipljan	103,011.00 €	46,989.00 €	150,000.00 €	0.00 €	103,011.00 €	1
9	Malishevë/Mališevo	77,964.00 €	36,125.00 €	114,089.00 €	69,157.94 €	8,806.06 €	1
10	Mamushë/Mamuša	9,377.00 €	0.00 €	9,377.00 €	8,990.00 €	387.00 €	1
11	Mitrovicë e jugut/Južna Mitrovica	27,756.00 €	5,000.00 €	32,756.00 €	32,756.00 €	0.00 €	1
12	Novo Brdo/Novobërdë	21,838.00 €	3,000.00 €	24,838.00 €	31,476.73 €	0.00 €	3
13	Obiliq/Obilić	50,634.00 €	10,000.00 €	60,634.00 €	50,633.96 €	0.04 €	1
14	Pejë/Peć	213,682.00 €	180,318.00 €	394,000.00 €	374,727.05 €	0.00 €	10
15	Podujevë/Podujevo	136,651.00 €	110,000.00 €	246,651.00 €	237,748.54 €	0.00 €	2
16	Prizren/Prizren	212,681.00 €	370,067.00 €	582,748.00 €	112,681.00 €	100,000.00 €	2
17	Rahovec/Orahovac	95,493.00 €	135,000.00 €	230,493.00 €	279,613.65 €	0.00 €	2
18	Shtime/Štimlje	68,410.00 €	78,920.00 €	147,330.00 €	138,472.00 €	0.00 €	1
19	Skenderaj/Skenderaj	65,538.00 €	14,462.00 €	80,000.00 €	39,153.50 €	26,384.50 €	1
20	Štrpce/Shtërpcë	28,871.00 €	1,262.00 €	30,133.00 €	29,466.13 €	0.00 €	1
21	Suharekë/Suva Reka	83,070.00 €	26,825.00 €	109,895.00 €	109,445.00 €	0.00 €	1
22	Viti/Vitina	52,107.00 €	62,079.00 €	114,186.00 €	80,681.00 €	0.00 €	2
	Të shpenzuara	1,557,819.40 €					
	Totali	1,796,416.00 €	183,548.00 €	481,544.00 €	397,217.63 €	26,384.50 €	

Shtojca 2 Motivi i auditimit, kriteret e auditimit, metodologjia dhe fushëveprimi

Motivi i auditimit

Marrëveshja e cila rregullon shpërndarjen e granteve nuk kërkon asnjë propozim standard të monitorimit, raportimit ose auditimit të veçantë për grantet e dhëna komunave. Sidoqoftë, sipas marrëveshjes mund të kërkohet një auditim vjetor i posaçëm për një grup komunash të përzgjedhura rastësisht, për të shqyrtuar një ose më shumë aspekte të menaxhimit financiar publik në lidhje me projektet e investimeve kapitale, për shembull: proceset e prokurimit, procedurat për pranimin teknik të shërbimeve, pagesat, etj.

Prandaj, donatori (DEMOS) ka bërë kërkesë në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA) që të kryhet ky auditim, në mënyrë që të marrin siguri se granti është duke i shërbyer qëllimit për të cilin ndahet.

Granti i Performancës, është i rëndësishëm për nga vlera dhe qëllimi. Qëllimi i grantit është të kontribuojë në ngritjen e performancës së komunave, andaj auditimi i projekteve të financuara nga granti ofron mundësi të vlerësojë këtë performancë. Përderisa grantet janë të destinuara për të gjithë qytetarët e komunës përkatëse, ata gëzojnë të drejtën të dinë se ku dhe si janë shpenzuar mjetet e grantit. Andaj Zyra Kombëtare e Auditimit me auditim të këtyre projekteve synon të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme për donatorin dhe qytetarët se si po shpenzohen mjetet e këtij granti.

Objektiva e auditimit

Objektivë e këtij auditimi është që të vlerësojë nëse procesi i prokurimit për projektet kapitale të financuara nga granti i DEMOS është në pajtim me kërkesat ligjore që nga planifikimi deri te realizimi i kontratës.

Objektivë tjetër e këtij auditimi është që të vlerësojë nëse këto projekte kanë arritur qëllimin e synuar, d.m.th nëse me anë të këtyre investimeve komuna ka përmirësuar ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët.

Pyetjet e auditimit

Për të iu përgjigjur objektives së auditimit ne kemi parashtruar pyetjet dhe nën pyetjet e auditimit si në vijim:

I. A janë kryer procedurat e prokurimit në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik (LPP)?

- A është bërë planifikimi i projekteve në mënyrë të duhur?
- A ka qenë efikas AK në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik?

- A është bërë procesi i menaxhimit të kontratës siç duhet?
- A janë shpenzuar fondet për qëllimin e kontraktuar, në kohën e duhur dhe në përputhje me rregullat financiare?

II. A ka ndikuar projekti i financuar në përmirësimin e shërbimeve publike për qytetarët?

- A janë përfshirë kërkesat e qytetarëve dhe a janë konsultuar ata gjatë marrjes së vendimeve se çfarë të investohet?
- A janë përfshirë kërkesat e grupeve të margjinalizuara të shoqërisë në këto projekte?
- A janë funksionalizuar projektet me qëllim të përdorimit nga qytetarët?

Kriteret e auditimit[19]

Për të verifikuar objektiven e auditimit, ne kemi vënë një kriter kryesor dhe disa nën kritere. Disa nga kriteret e përcaktuara janë kritere që i parasheh vet marrëveshja e nënshkruar në mes MAPL dhe Agjencia zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC), ndërsa disa kritere tjera janë sipas ligjit dhe rregullave në fuqi (të cilat po ashtu i parasheh marrëveshja) dhe disa nga praktikat e mira.

Shpenzimi i këtyre fondeve duhet të jetë vetëm për investime kapitale. Këto investime duhet të investohen në të mirë të qytetarëve dhe gjatë kontraktimit të këtyre projekteve duhet të përdoren procedurat në pajtim me ligjin e prokurimit publik.

- Komunat duhet që grantin e fituar në bazë të performancës së tyre ta shpenzojnë vetëm për projekte të investimeve kapitale; (sipas marrëveshjes MAPL- SDC)
- Projekti duhet të jetë i përfshirë në planin e prokurimit, PIP dhe ligj të buxhetit të Autoritetit Kontraktues për atë vit; (sipas Udhëzuesit Operativ i prokurimit publik, Ligjit të Buxhetit dhe)
- Procedurat e prokurimit duhet të jenë në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik në Kosovë; (sipas marrëveshjes MAPL- SDC)
- Shpenzimet duhet të jenë të mbështetura në mënyrë të duhur me dokumente origjinale; (sipas librit të procesevepër menaxhimin e shpenzimeve publike)
- Pranimi i punëve/mallit është bërë dhe përdoret në përputhje me bazën kontraktuale të projektit; (sipas neneve në kontratat përkatëse)
- Projekti duhet të jetë në përputhje me marrëveshjen e grantit dhe shpenzimet duhet të jenë ekskluzivisht për projektin e aprovuar fillimisht; (sipas marrëveshjes MAPL-SDC dhe ligji i buxhetit 2018);
- Kërkesat e qytetarëve për investime duhet të merren parasysh në procesin e vlerësimit të nevojave dhe prioritizimit të investimeve; (sipas marrëveshjes MAPL-SDC)

[19] Për më shumë informata konsultoni ISSAI 300, Criteria, p.7

- Autoritetet kontraktuese duhet që investimet e tyre ti shpërndajnë në atë mënyrë, që në to te kenë qasje te gjitha grupet e qytetareve (pa dallim feje, race, etnie, gjinie, bindje politike etj); (praktikat e mira)
  Komunat duhet të përfundojnë këto projekte në kohë dhe të jenë lehtë të qasshme për përdorim në mënyrë që qytetarët të përfitojnë nga këto projekte (sipas marrëveshjes MAPL-SDC).

Fushëveprimi i auditimit

Me këtë auditim synojmë që të ofrojmë rekomandime relevante për nivelin komunal si pjesë e grantit të performancës dhe palët tjera te interesit në mënyrë që të përmirësojnë qasjen e tyre në raport me donacionet dhe mënyrën e investimeve të tyre.
Ne kemi audituar shtatë kontrata: tre në komunën e Pejës, një në komunën e Prizrenit (dy projekte të realizuara në një kontratë), një në Podujevë, një në komunën e Mamushës dhe një në komunën e Graçanicës. Përzgjedhjen e komunave dhe projekteve për auditim e kemi bërë bazuar në shpenzimet më të larta edhe ato më të ulëta, në mënyrë që të kemi një pasqyrë të saktë për të gjitha llojet. Periudha kohore ka përfshirë grantin e dhënë për vitin 2018. Është audituar procesi që nga kërkesat e qytetarëve, prioritizimi i këtyre kërkesave, aprovimi i projektit, futja e projektit në planin e prokurimit, procedurat e tenderimit, dhënia e kontratës dhe deri te pranimi e projektit.

Metodologjia e auditimit

Qasja jonë për auditimin e këtyre projekteve përfshinë një varg teknikash:

- Analizimi i kornizës ligjore rregulluese, marrëveshjes përkatëse në mes MAPL, QK dhe SDC;
- Analizimi i kërkesave në dëgjimet publike dhe krahasimi i tyre me prioritizimet për investime të komunës;
- Analizimi i dosjeve të prokurimit dhe krahasimi i tyre me procedurat e Prokurimit Publik në fuqi;
- Intervistimi i zyrtarëve përgjegjës rreth procesit të prioritizimit të investimit në projektet konkrete;
- Intervistimi i qytetarëve rreth përfitimeve nga projektet e investuara nga komuna.
- Krahasimi i pagesave me realizueshmërinë e punëve.

Shtojca 3 Përmbledhje e temave të grantit të performancës

#	TEMA / FUSHA E TREGUESIT	# MAKS. I PIKËVE
QEVERISJA DEMOKRATIKE		**40**
I	**Roli i kuvendit komunal si organ mbikëqyrës**	**20**
1	Kuvendi komunal e miraton buxhetin vjetor me kohë	3
2	Kuvendi komunal i diskuton shpenzimet kundrejt raporteve buxhetore në baza të rregullta	5
3	Diskutimet mbi raportin e performancës komunale nga kuvendi komunal	4
4	Pjesëmarrja e kryetarëve të komunave në mbledhjet e kuvendit komunal	3
5	Kuvendi komunal i diskuton gjetjet e raporteve të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm	5
II	**Pjesëmarrja dhe konsultimi i qytetarëve**	**10**
6	Takimet publike të komunës të kërkuara me ligj shpallen siç duhet dhe me kohë	4
7	Konsultimi publik mbi aktet komunale para miratimit nga kuvendi komunal	6
III	**Gjithëpërfshirja**	**10**
8	Pjesëmarrja e grave në takimet publike të komunës me qytetarët	4
9	Gratë e emëruara në pozita politike në komunë	3
10	Respektimi nga komuna i përdorimit të gjuhëve zyrtare lokale	3
MENAXHIMI KOMUNAL		**40**
IV	**Menaxhimi i burimeve njerëzore**	**10**
11	Vlerësimet e personelit bëhen çdo vit dhe në pajtim me kërkesat ligjore	3
12	Konkurset për shërbyes civil procedohen përmes Sistemit të Informimit për Burimet Njerëzore	2
13	Kuvendi komunal e diskuton raportin vjetor të burimeve njerëzore	2
14	Kontratat për Shërbime të Veçanta janë në pajtim me kornizën ligjore	3
VI	**Menaxhimi dhe kontrolli financiar**	**20**
15	Faturat paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh	3
16	Zbatimi i planit vjetor të prokurimit	3
17	Regjistri i tatimit mbi pronë përditësohet rregullisht	3
18	Inkasimi i tatimit vjetor mbi pronë (pa borxhe, gjoba, kamat, etj.)	5
19	Rekomandimet me prioritet të lartë dhe mesatar nga ZKA janë adresuar	6
VI	**Ofrimi i shërbimeve**	**10**
20	Trajtimi nga komuna i kërkesave dhe ankesave	4
21	Menaxherët e projektit të emëruar për monitorimin e zbatimit të kontratës	3
22	Ekzekutivi komunal verifikon, para pagesës përfundimtare, përmbushjen e kënaqshme të kontratave	3
TRANSPARENCA DHE INTEGRITETI		**20**
VII	**Qasja në informata**	**10**
23	Uebfaqja komunale është e përditësuar në pajtim me kërkesat ligjore	3
24	Trajtimi i kërkesave të qytetarëve për dokumente publike	3
25	Publikimi i akteve të miratuara nga kuvendi komunal dhe nga kryetari i komunës	4
VIII	**Integriteti**	**10**
26	Kuvendi komunal e diskuton raportin e realizimit vjetor të planit të integritetit	4
27	Pezullim i shërbyesve civil të akuzuar për keqpërdorim të pozitës zyrtare	6

Shtojca 4 Letërkonfirmimet

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës **"Projektet e financuara nga grantet e DEMOS (për vitin 2018)"** dhe për implementimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data:
Gracanica, 27.11.2019.

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për **"Projektet e financuara nga grantet e DEMOS (për vitin 2018)"** (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari,
Srdjan Popovic

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës

Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika Kosova-Republic of Kosovo
Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës
Opština Mamuša-Municipality of Mamusa
Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing
02 No.Nr. 224-19
Tarih/Dt. 02.12.2019

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit tëperformancës **"Projektet e financuara nga grantet e DEMOS (për vitin 2018)"**dhe për implementimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit
Vendi: Mamushë
Data: 02.12.2019

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për "**Projektet e financuara nga grantet e DEMOS (për vitin 2018)**"(në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari,
Abdülhadi Krasniç

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës **"Projektet e financuara nga grantet e DEMOS (për vitin 2018)"** dhe për implementimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data:
Pejë: **05/12/2019**

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për **"Projektet e financuara nga grantet e DEMOS (për vitin 2018)"** (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari,
Gazmend Muhaxheri

PRIZREN

REPUBLIKA E KOSOVËS * REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit * Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 161/19 Dt. 03.12.201

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës **"Projektet e financuara nga grantet e DEMOS (për vitin 2018)"** dhe për implementimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data:

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për "**Projektet e financuara nga grantet e DEMOS (për vitin 2018)**" (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Prof. Dr.Mytaher Haskuka

Kryetar i Komunës së Prizrenit

KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE
Regjuar më ... 05/12/2019
Nr. Br. 02-016/01-0091809/19
PODUJEVË - PODUJEVO

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës **"Projektet e financuara nga grantet e DEMOS (për vitin 2018)"** dhe për implementimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për "**Projektet e financuara nga grantet e DEMOS (për vitin 2018)"** (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Datë: 05 dhjetor 2019
Podujevë,

Kryetari i Komunës
Agim Veliu